

EKSPOZE E TEMËS:
STUDIMET E HISTORIOGRAFISË SHQIPTARE PËR LIDHJEN
SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Nga:

PËRPARIM SAHITAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

2021

STUDIMET E HISTORIOGRAFISË SHQIPTARE PËR LIDHJEN SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Mentori: Prof. Dr. Ass. Selim Bezeraj

Kandidati: Përparim Sahitaj

Tema „Studimet e historiografisë shqiptare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit”, është realizuar me qëllim që të hedh dritë mbi pikëpamjet e studiueseve shqiptar për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Ky hulumtim është i pari apo pionier në studimet historiografike që përmbledhen si tërësi tematike në trajtimin kronologjik dhe përmbajtjesor.

Metodat studimore të përdorura gjatë punimit hulumtues të kësaj teme janë: krahasuese, analizës, analogjike dhe e sintezës.

Struktura e temës është: abstrakti, parathënie, hyrje. Në kapitulli e parë trajtohet “Lidhja shqiptare në kontekstin historik”, ku ndodhën ngjarje mjaft të rëndësishme për popullin shqiptar, duke filluar me nisma për thirrjen e Kuvendit të Përgjithshëm sigurisht mospajtimi i Fuqive të Mëdha lidhur me Traktatin e Shën Stefanit dhe përgatitjet për mbajtjen e Kongresit të Berlinit u jepnin mundësi shqiptarëve të organizonin më mirë qëndresën politike e ushtarake dhe t’i bënin ballë rrezikut të copëtimit të atdheut nga popujt fqinjë. Në radhët e atdhetarëve dominonte ideja për formimin e një lidhje gjithëpërfshirës. Lidhja e Prizrenit ishte një përpjekje serioze e vënies së fundamentit dhe e formësimit të shtetit shqiptar. Pjesëmarrja në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit morën pjesë të gjithë shtresat shoqërore shqiptare si p.sh. Intelektualëve, agallarëve, tregtarëve, zejtarëve, klerikëve etj. Më 10 qershor të vitit 1878 filloi punimet Kuvendi i Prizrenit. Në të merrnin pjesë figura të shquara si: Iliaz Pashë Dibra, Abdyl Frashëri, Ali bej Guçia, Hasan Pashë Tetova, Ymer Prizreni, Ahmet Koronica, Sylejman Vokshi, Shuajp Spahiu etj. Kuvendi zgjodhi kryetar Ilijaz Pashë Dibrën. Ideja e përhapur qysh më parë për të formuar një lidhje të përgjithshme shqiptare me karakter kombëtar gjeti mbështetje te pjesëmarrësit e Kuvendit. Lidhja e Prizrenit do bënte të ditur Kongresit të Berlinit që do të mbahet pas tri ditësh, se populli shqiptar ishte i vendosur të luftonte kundër çdo vendimi që do të cenonte ndonjë pjesë të atdheut të tij. Një pjesë të rëndësishme e zë dokumentet dhe aktet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në të cilën trajtohet aktet e para të Kuvendit të Përgjithshëm ishin: një peticion për çështjen shqiptare, dërguar Kongresit të Berlinit, një peticion, dërguar Portës së Lartë, Kararnameja (Akti i Vendimeve-Kanuni) dhe Talimati (Urdhëresa). Të dyja peticionet u miratuan më 15 qershor 1878.

Në kapitullin e dytë pasqyrohen “Historiografia shqiptare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit gjatë periudhës protohistoriografike (1912 – 1944)”. Vend të veçantë i është kushtuar autorëve si Kristo Dako me veprën Liga e Prizrenit e para lëvizje kombëtare për të mbrojtur tersin tokësore të atdheut dhe për të fituar independencën e Shqipërisë, shoqëruar në dokumente zyrtare. Po ashtu edhe autori Mehdi Frashëri me veprën Liga e Prizrenit dhe efektet diplomatike të saj. Një pjesë të rëndësishme e zë Xhafer Belegu me veprën Lidhja e Prizrenit dhe veprimet e saj.

Ndërsa në kapitullin e tretë trajtohet “Historiografia shqiptare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit gjatë periudhës (1944 – 1990)”. Kthesa drejt kërkesave të metodologjisë shkencore, ndodhi pas Luftës së Dytë Botërore. Angazhimi i Shqipërisë për transformimin socialist të vendit i dha jetës shkencore dy faktorët themelorë që përcaktuan zhvillimin e saj të shpejtë: metodologjinë, e cila i dha punës shkencore cilësinë dhe dinamizmin që e ndihmoi të rifitonte kohën e humbur nga prapambetja e së kaluarës. Vend të veçantë i është kushtuar autorëve të cilët kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për shkrimin dhe dokumentimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të cilët janë: Aleks Buda, Lidhja Shqiptare e Prizrenit Nga duhet të shkojmë?; Arben Puto, Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit në vitet e Krizës Lindore; Stefanaq Pollo, Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirimin e bashkimit kombëtar; Ali Hadri, Kontribut për ndriçimin e Lidhjes së Prizrenit 1878 – 1881; Selami Pulaha, Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për krijimin e provincës autonome të Shqipërisë; Ligor Mile, Rreth organizimit politik, pushtetar dhe ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; Koli Xoxi, Lidhja Shqiptare e Prizrenit; Bedrush Shehu, Lidhja Shqiptare në Srpski list; Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit; Shyqri Ballvora, Lufta e Lidhjes Shqiptare për mbrotjen e tërsis territorial të Shqipërisë; Pajazit Nushi, Lidhja e Prizrenit dhe komponentët kryesore të etnitetit çlirimtar të saj; Gazmend Shpuza, Gjurmime në Epokën e Rilindjes Kombëtare; Masar Rizvanolli, Lidhja e Prizrenit; Rexhep Qosja, Letërsia e Rilindjes dhe Lidhja e Prizrenit; Zihni Haskaj, Jehona e Lidhjes së Prizrenit në Lëvizjen për Çlirimin Kombëtar; Skender Rizaj, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885; Ilijaz Rexha, Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane; Kristaq Prifti, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878-1881. Marjan Prenkaj Dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881.

Studimet historike në planë të gjerë pas Luftës së dytë Botërore morën trajtën e institucionalizuar. Amatorizmi dhe pasioni patriotik për t’u marrë me studimin e historisë kombëtare ia la vendin profesionit të studiuesit, pra studimi i historisë u shëndrra në profesion i cili gëzon edhe mbështetjen institucionale të shtetit, megjithatë kufizimet ideologjike, metodologjike ishin esenciale për këtë periudhë, pra përveç këtyre afirmimeve gjatë kësaj periudhe dominonte në mënyrë absolute dhe pa asnjë alternative metodologjia marksiste, respektivisht ato u bënë udhërrëfyes në fushën e studimeve historike

Protohistoriografisë, historiografinë e dokumentuar të viteve 1945 – 1990 do ta përcjellin ideologjizmat, si të tillë mendoj që e zbehin atë objektivitetin drejtë historisë, duke u ngritur me petkun herë hyjnor siç ndodh edhe me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, jo çdo herë një pikturë në korniza është artistike në këtë rast ka edhe botime të tilla edhe pse qenë në korniza lanë për tu dëshiruar forma, interpretimi, megjithëkëtë brenda këtij populacioni, mostra e historiografisë shqiptare e kësaj periudhe kohore nuk tentoi të dal nga shabllonet ideologjike, edhe pse kjo periudhë konsiston me botimet e mëdha mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit pa e hedhur poshtë kontributin gjatë kësaj periudhe, por është shqetësuese se ky shabllon vazhdoi ti përcjell herë here edhe pas periudhës postkomuniste.